

**LIGJ**  
**Nr.7696, datë 7.4.1993**

**PËR SHËRBIMIN E ROJAVE CIVILE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Në Republikën e Shqipërisë krijohet shërbimi i rojave civile.

**Neni 2**

Shërbimi i rojave civile ka për detyrë ruajtjen e objekteve në pronësi ose në përdorim të personave juridikë a fizikë, shqiptarë a të huaj, ruajtjen e rendit në këto objekte dhe sigurimin e jetës së personelit e të vlerave pasurore të tyre gjatë lëvizjeve.

**Neni 3**

Shërbimi i rojave civile organizohet nga firma private të krijuara posaçërisht për këtë qëllim, të pajisur me licencë nga organet e rendit publik, që veprojnë vetëm në njësi të caktuara administrative territoriale. Ai kryhet edhe nga persona privatë, pa bërë pjesë në firmë, të pajisur me licencë nga organet e rendit publik.

**Neni 4**

Numri i efektivit të rojave civile që punëson një firmë, përcaktohet në marrëveshje me organet e rendit publik, por gjithnjë më pak se 5 për qind e gjithë efektivit të policisë së rendit të njësisë administrative ku vepron.

Firma e shërbimit të rojave civile i përzgjedh vetë ata që duan të punojnë si roja civile dhe ua kalon për miratim organeve të rendit publik për dhënien e lejes (licencës) së ushtrimit të profesionit.

Procedura e dhënies së licencave dhe organi që do t'i japë ato, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

**Neni 5**

Në shërbimin e rojave civile pranohen personat fizikë që plotësojnë këto kërkesa:

- Të jenë shtetas shqiptarë.
- Të kenë mbaruar arsimin e detyruar.
- Të kenë kryer shërbimin ushtarak të detyrueshëm.
- Të mos jenë dënuar për krime kundër pasurisë shtetërore e private, për krime kundër moralit dhe për krimin e vrasjes.
- Të plotësojnë kushtet shëndetësore e fizike.

**Neni 6**

Rojat civile pajisen me armë e mjete të tjera, me uniformë të veçantë dhe me dokumente që vërtetojnë identitetin e tyre dhe objektin ku shërbejnë.

Lloji i armës, i mjeteve dhe i uniformës caktohet nga ministri i Rendit Publik.

#### Neni 7

Për plotësimin e detyrave në objektin që ruajnë, rojat civile kanë këto të drejta:

- a) Të kërkojnë nga shtetasit zbatimin e rregullave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të objektit.
- b) Kur në objekt kryhen vepra penale, rojat civile bëjnë bllokimin e mjedisit e të autorit dhe njoftojnë menjëherë organet kompetente për të kryer veprimet e mëtejshme procedurale, ruajnë vendin e ngjarjes, provat materiale dhe sendet e tjera që kanë shërbyer si mjet për kryerjen e veprës penale.
- c) Të përdorin armën në bazë të dekretit nr.7449, datë 5.1.1991 "Për përdorimin e armëve të zjarrit".

#### Neni 8

Ministria e Rendit Publik kujdeset për aftësimin profesional të rojave civile dhe shpenzimet që bëhen për këtë, përballohen nga personi juridik ose fizik. Format e punës për aftësimin profesional të rojave civile dhe shpenzimet që bëhen për këtë punë përcaktohen me rregullore të ministrit të Rendit Publik.

#### Neni 9

Kur vërehet që rojës civile i mungon një a disa nga kushtet e përcaktuara në nenin 5, keqpërdor ose humbet lejen e ushtrimit të profesionit, organet e rendit publik urdhërojnë pezullimin nga shërbimi deri në marrjen e vendimit nga organi kompetent.

#### Neni 10

Shërbimi i rojeve civile, për kryerjen e detyrave të tij, bashkëpunon me policinë e rendit, policinë financiare, policinë pyjore dhe me të gjitha llojet e policive të tjera.

#### Neni 11

Policia e rendit publik ushtron kontroll të vazhdueshëm në zbatimin e këtij ligji. Kur është e nevojshme, ajo i ushtron kompetencat e saj edhe brenda juridiksionit të rojave civile.

#### Neni 12

Ndalohet marrja në punë e shtetasve si roja civile nga persona juridikë a fizikë të papajisur me licencë.

#### Neni 13

Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 3, 4 5 e 12 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 50.000 lekë.

Gjoha jepet me vendim të shefit të policisë së rrethit. Kundër këtij vendimi bëhet ankim brenda 5 ditëve te kryetari i degës së rendit publik, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

#### Neni 14

Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij ligji përcaktohen me akte të Këshillit të Ministrave dhe të ministrit të Rendit Publik.

#### Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr. 524, datë 23.4.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**